



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 181, datë 01.12.2023

PËR MOSMIRATIMIN E KËRKESËS “PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KËSHILLIT NË LIDHJE ME “PËRDORIMIN E FONDEVE TË RINDËRTIMIT NGA BASHKIA DURRËS DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË PËRFITUESVE”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “a” të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 41, neni 55 pika 3, neni 153 pika 1, shtojca 16, të Rregullores së Funkcionimit dhe Organizmit të Këshillit Bashkiak,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Mosmiratimin e kërkesës “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Këshillit në lidhje me “Përdorimin e fondeve të rindërtimit nga Bashkia Durrës dhe kriteret e përzgjedhjes së përfituesve”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK


Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 04.12.2023

Durrës më, 03 / 11 / 2023.

KËRKESË



Për
krijimin e një Komisioni të Përkohshëm (Hetimor).

DREJTUAR: KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK,
BASHKIA DURRËS.

BAZA LIGJORE: Neni 54/a i Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 41 dhe shtojca nr.16 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës.

Këshilltarët Bashkiak të Opozitës e kanë ndjekur me shqetësim procesin e "Rindërtimit" në Bashkinë Durrës për shkak të problematikave të denoncuar në media, opozita por edhe nga organizma ndërkombëtar të cilat monitorjnë legjitimitetin e zgjedhjeve, që e lidhin këtë proces me faktin e përdorimit të tij për joshjen e qytetarëve në dy palë zgjedhjet e fundit me qëllim përfitimet elektorale nga mazhoranca. Ky proces është shoqëruar me mungesë të transparencës, edhe për faktin që opozita nuk ka pasur përfaqësuesit e saj në Këshillin Bashkiak dhe nuk ka pasur mundësi të monitorojë sic duhet ecurinë dhe zbatimin e ligjit në zgjidhjen e problematikave të hasura nga qytetarët. Në këto kushte, e gjykojmë të nevojshme, madje emergjente, ngritjen e një Komisioni Hetimor, në lidhje me fondet e rindërtimit.

Me ngritjen e këtij Komisioni Hetimor, Grupi nismëtar i Këshilltareve të opozitës kërkon të identifikojë si janë përdorur fondet nga ana e Bashkisë Durrës duke propozuar për miratim si më poshtë:

- A. Çështja objekt hetimi: "Përdorimi i fondeve të rindërtimit nga Bashkia Durrës dhe kriteret e përzgjedhjes së përfituesve".
- B. Propozimi për përbërjen e Komisionit: Propozojmë që ky Komision të përbëhet gjithsej nga 13 Këshilltar:

1. Kryetar Ardian MUKA
2. Anëtar LYAN NEZHA
3. Anëtar _____



4. Anëtar _____

5. Anëtar _____

6. Anëtar _____

7. Anëtar _____

C. Afati i propozuar për përfundimin e hetimeve të jetë data 01/02/2024.

GRUPI NISMËTAR

1. Androni Leka
2. Dr. Anu Zurgjite
3. Eren Lasi
4. Ajete Feci
5. Edlira Qerem
6. Anisa Ibrahimaj
7. BLEUAR PRIZREMI
8. Emel Brahalli
9. Kujtiane Kuci
10. Jonë Pëllata
11. Saimi Durrës
12. Juon Nezha
13. Arden Boalli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 766 prot.
19.

Durrës, më 13.12.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.181 datë 01.12.2023 “Për mosmiratimin e kërkesës “ Për ngritjen e komisionit hetimor të këshillit në lidhje me “Përdorimin e fondeve të rindërtimit nga Bashkia Durrës dhe kriteret e përzgjedhjes së përfituesve”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

